

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Nr. 08-2227/2

20.09.2023

Kërçovë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 25-të e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 20.09.2023 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10 e 20 minuta.

Seancën e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Kamer Klosi, Drenuse Dalipi, Valbona Adili Emini, Agim Sadiku, Abdulla Sejdini, Filip Mitreski, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Laze Jaqimoski, Olgica Poposka, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Argjent Asani, Valentina Llazaroska, Ivanço Bozhinoski, Viktor Aleksoski, Ramazan Zulbeari, Fortesa Sejdini dhe Sibel Tufkegji.

Në mungesë ishte këshilltari Migjen Zendeli.

Në seancë morrën pjesë edhe përfaqësues të administratës komunale të Komunës së Kërçovës: Bujar Veseli, Aneta Nasteska- Sekretare e Komunës së Kërçovës, dhe Igor Pejsoki, dhe Drejtorët e SHMK „Drita,, Kërçovë, SHMK „Mirko Mileski,, Kërçovë, SHF „Kuzman Josifoski-Pitu,, Kërçovë, SHF „Hristo Uzunov,, Dërgovë, SHF „Rexhë Rushit Zajazi,, Zajas, SHF „Milton Gurra,, Strellcë, SHF „Naim Frashëri,, Jagoll Dolenci,, SHF „Gjergj Kastrioti Skenderbeu,, Sërbicë, SHF „Faik Konica,, Greshnicë,, Zv, Drejtori i SHF „Sande Shtrejoski,, Kërçovë, Drejtori i universitetit të Punës „Krste Misirkov,, përfaqësuesi i NK „Komunalec,, Kërçovë.

Kryesuesi e lexoi propozim rendin e ditës si vijon.

Propozim rendi i ditës

1. Propozim Vendim për ridestinimin e mjeteve në Buxhetin e Komunes së Kërçovës 2023.

2. Propozim Vendim për pagesën e kotizimit të klubeve futbollistike për sezonin 2023/2024 nga Komuna e Kërçovës të cilët garojnë në ligën e 3-të Perendim.

3. Raport për punën financiare për kuartalin e dytë, nga 01.01.2023 deri 30.06.2023 të NP "Komunalec" Kërçovë.

4. Propozim Vendim për miratimin e raportit për vlersimin e demit te fatkeqësive të ndryshme – Zjarr nr. 06- 464/2 më datë 28.02.2023

5. Propozim Vendim për miratimin e raportit për vlersimin e demit te fatkeqësive të ndryshme – Zjarr nr. 06- 465/2 më datë 28.02.2023

6. Propozim Vendim për miratimin e raportit për vlersimin e demit te fatkeqësive të ndryshme – Zjarr nr. 06- 466/2 më datë 28.02.2023

7. Propozim Vendim për miratimin e raportit për vlersimin e demit te fatkeqësive të ndryshme – Zjarr nr. 06- 467/2 më datë 28.02.2023

8. Miratimi i Programit Vjetor për punë të shkollave Fillore dhe të Mesme në teritorin e Komunës së Kërçovës:

SHMK "Drita" Kërçovë.

SHMK "Mirko Mileski" Kërçovë.

SHF "Sande Shterjoski" Kërçovë.

SHF "Kuzman Josifoski Pitu" Kërçovë.

SHF "Hristo Uzunov" Dërgovë.

SHF "Rexhë Rushit Zajazi" Zajaz.

SHF "Milto Gurra" Strellcë.

SHF "Naim Frashëri" Jagoll Dolencë.

SHF "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Sërbicë.

SHF "Faik Konica" Greshnicë.

9. Propozim Vendimi për Rikonstituimin e shkollës së parë në gjuhën maqedone në teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në fshatin Podvis.

10. Miratimi i planit vjetor për punësim për vitin 2024 dhe Balancier.

11. Të ndryshme.

Para miratimit të rendit të ditës, kryetari i këshillit informon se ka ndryshim në rendin e ditës me tre pika të reja, të cilat do t'i sqarojë sekretari, të cilat nuk janë futur në

rendin e ditës, sepse nga BNJVL-ja është marrë shkresë lidhur me to menjëherë pas dërgimit të materialeve për seancën .

Më pas, kryesuesi i vendosi për miratim procesverbalet e seancës së 23-të të këshillit të Komunës së Kërçovës të mbajtur më 18.07.2023, dhe seancën e 24-të të këshillit të mbajtur më 11.08.2023.

Agim Sadiku- Informon se procesverbali duhet të hartohet në kohë dhe nga çdo seancë paraprake të vendoset për miratim , sepse është e mundur të harrohet se kush çfarë ka thënë.

Kryetari i këshillit pajtohet me këtë.

Valentina Lazarevska - Informon se ka vërejtje në procesverbalin e seancës së 23-të me rastin e votimit të pikës së 4-të dhe duhet të plotësohet: “se Valentina Lazarevska është e liruar nga votimi, sepse është e punësuar në atë shkollë”, ndërsa në pikën e 15-të pas garave në lëminë e Matematikës të shënohet edhe “Shkencat Natyrore”.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim procesverbalin e seancës së 23-të të këshillit të mbajtur më 18.07.2023 me vërejtjet e dhëna dhe i njejtë u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë).

Mihajlo Daniloski- Informon se në procesverbalin e seancës së 24-të ka një vërejtje, në pikën e dytë është dashur të thuhet se ka qenë kundër ridestinimit, sepse për të njëjtin ridestinin janë siguruar mjete në mënyrë jokorrekte dhe kontrabandë nga sektori i financave me në kryes personin përgjegjës Burim Kadriu për objektin në Ivanidol, për të cilin shprehimisht jam kundër dhe këtu të gjithë e dimë se kush është për ndihmën e qytetarëve, e kush për taksa më të larta, për objekte kundër vullnetit të qytetarëve.

Valentina Lazareska- Informon se në procesverbalin e seancës së 24-të ka vërejtje në pikën e 4-të ku duhet të thuhet: “Në Vendimin e formuluar në këtë mënyrë, “ndihma financiare u jepet nxënësve”, e jo shkollave” dhe kërkoi që ajo të ndryshohet.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim procesverbalin e seancës së 24-të të këshillit të mbajtur më 11.08.2023 me vërejtjet e dhëna dhe i njejtë u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit theksoi se rendi i ditës plotësohet me këto pika:

1. Vendim për ndryshimin e Rregullores për llogaritjen e pagave të nëpunësve publikë në Komunën e Kërçovës.

2. Vendim për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e vlerës së pikës për pagat e zyrtarëve administrativë për vitin 2023.

3. Vendim për ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e pagave, shtesave dhe kompensimeve të pagave të punëtorëve të NJTKZ Kërçovë të cilët kanë statusin e zyrtarëve të autorizuar në fushën e sigurisë.

Sekretarja e komunës - Bën me dije se në pikën e 9-të të rendit të ditës, pas fillimit të fjalëve, duhet të shkruhet: “procedurë për,, më pas,,, rikonstruimin e....,,. Ajo theksoi se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive është ndryshuar në qershor dhe pritej që të kishte një zgjidhje ligjore për këtë dhe që 10% të futej në Ligjin për nëpunës publik dhe civil. Nga ana e BNJVL-së është marrë shkresë se komunat me Rregullore është dashur ta zgjidhin vetë këtë, prandaj është vonuar. Vetëm pika u ndryshua, pjesa tjetër mbetet e njëjtë.

Valentina Lazareski- Informon se miratimi i Programeve Vjetore të shkollave fillore dhe të mesme duhet të jetë në pika të veçanta. Ajo ka theksuar se programet për shkollat fillore është dashur të miratohen deri më 31 gusht, sepse nëse nuk miratohen deri në atë afat, do të konsiderohen të miratuara. Për shkollat e mesme, programet duhet të ishin miratuar deri më 30 shtator. Ajo propozoi që pika e 8-të të jetë: Miratimi i programeve vjetore të punës së shkollave të mesme në territorin e Komunës së Kërçovës: SHMK,,,"Drita" Kërçovë dhe SHMK,,,"Mirko Mileski", Kërçovë, dhe pika 9 të të jetë: Miratimi i programeve vjetore të punës së shkollave fillore në territorin e Komunës së Kërçovës: - SHF,,,"Sande Shterijoski", SHF,,,"Kuzman Josifoski-Pitu, SHF,,,"Hristo Uzunov" Dërgovë, SHF,,,"Rexhë Rushit Zajazi' Zajas, SHF ,,,"Milto Gurra,, Strellcë, SHF ,,,"Naim Frasheri,, Jagoll Dolencë, SHF ,,,"Gjergj Kastrioti Skenderbeu, Sërbicë dhe SHF ,,,"Faik Konica,, Greshnicë.

Agim Sadiku - Ai bën me dije se ka një vërejtje për pikën e parë të rendit të ditës, përshkak se nuk ka kaluar në Komisionin për Financa, sepse nuk është mbajtur. Po ashtu, pikat e pagave është dashur të kalojnë në komision, ndaj ka sygjerruar që ato pika të tërhiqen nga rendi i ditës, të analizohen dhe të futen në rendin e ditës për seancën e ardhshme. Ai theksoi se ishte i revoltuar pasi materialet nuk ishin dorëzuar në kohë, por një orë para seancës dhe jo 7 ditë para seancës. Ai ka kërkuar që të respektohet Rregullorja dhe Statuti dhe të punohet në bazë të tyre. Pikat duhej të shkonin fillimisht në një komision, pastaj të shkonin në këshill, prandaj ai kërkoi tërheqjen e tyre.

Kryetari i këshillit - Informon se vërejtja e Agimit është e me vend. Por bëhej fjalë për një pikë dhe faji mund të jetë edhe i tij, përshkak se nuk njoftoi për të caktuar komision.

Më pas, kryetari i këshillit e vendosi propozimin e Agimit për tërheqjen e pikave të para dhe tri pikave të reja të propozuara nga rendi i ditës për miratim dhe nuk u miratua me 5 vota PËR, 7 vota KUNDËR. 8 vota PËRMBAJTUR.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim rendin e ditës të propozuar për seancën e sotme, të plotësuar me tre pikat e reja dhe i njëjti u miratua me 18 vota PËR, KUNDËR (asnjë). 4 vota PËRMBAJTUR.

1. PIKA E PARË: Propozim Vendim për ridestinimin e mjeteve në Buxhetin e Komunes së Kërçovës 2023.

Bujar Veseli- Informon se ndryshimi ka qenë në Buxhetin bazë dhe ka të bëjë me ridestinim e mjeteve për ndërtimin e parqeve për fëmijë në vlerë prej 305.000 denarë. Njëri park do të jetë pranë urës pranë spitalit, tjetri pranë autostradës pranë Rashtanit dhe i treti te rrethrotullimit te „Llopshniku,,.

Abdulla Sejdini - Ai informoi se ne jemi i vetmi qytet në Maqedoni që nuk kemi park dhe se Programi për ndërtimin e parqeve ka dy vjet që po miratohet, ndoshta deri më tani janë rreth 20 parqe, pyeti se sa prej tyre janë ndërtuar.

Kryetari i këshillit – Informon se nuk ka të dhëna, dhe tani me këtë ishte planifikuar ndërtimi i 3 parqeve. Ka pasur kërkesë për ta dhe tani për mungesë mjeteve është bërë ky ndryshim në buxhet, për të siguruar mjete.

Abdulla Sejdini - Ai informoi se kjo është dëshmi se nuk janë ndërtuar 20 parqe dhe ka pyetur se cilat janë kompanitë që kanë konkurruar në thirrje.

Kryetari i këshillit - njofton se nuk ka qenë në komision dhe nuk e di.

Abdulla Sejdini- Bën me dije se çdo program që ishte përfshirë në buxhet nuk është realizuar. Tani u premtua se do të ndërtoheshin 3 parqe, por ku janë të tjerët? Ai pyeti nëse tre parqet me siguri do të ndërtoheshin për dy muaj e gjysmë, pasi që të tjerët nuk u ndërtuan për dy vjet.

Igor Stojanoski-Informon se nga diskutimi ka marrë përgjigje se do të ndërtohen 3 parqe, por është miratuar program për ndërtimin e 20 parqeve. Ai është për ndërtimin e 30, jo 3 parqe. Ai ka theksuar se ato është dashur të ndërtohen deri më tani, sepse kushtet atmosferike do të jenë më të këqija. Për njëzet vjet nuk kishte parqe dhe tani kishte nevojë për ridestinim të mjeteve të cilat mungojnë. Ai sugjeroi se do të ishte më mirë të kishte 2 në vend të 3 parqeve, por ato të ndërtoheshin mirë.

Valbona Adili Emini- Pyeti se ku do të ndërtohet saktësisht parku pranë spitalit?

Kryetari i këshillit informoi se do të ndërtohet përballë komunës së re.

Laze Jakimoski-Informon se Programi ka dy vite që është miratuar dhe asgjë nuk është realizuar dhe tani nuk kanë mundur të realizohet për 5 mijë euro. E papërfunduar ka mbetur edhe salla sportive e Jançicës, ku është vjedhur gjithçka. Ndërtimi i parkut pranë spitalit ishte një lokacion i ri dhe nuk është diskutuar në komision. Pyeti se në çfarë gjuhe ishte shkruar Vendimi për Buxhetin, sepse kishte shumë presje, pika, kllapa etj. dhe propozoi që të vendoset një rend për hartimin e Vendimeve.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për ridestinimin e mjeteve në Buxhetin e Komunes së Kërçovës 2023 dhe i njeiti nuk u miratua me 11 vota PËR. KUNDËR (asnjë) 11 vota PËRMBAJTUR.

2. PIKA E DYTË: Propozim Vendim për pagesën e kotizimit të klubeve futbollistike për sezonin 2023/2024 nga Komuna e Kërçovës të cilët garojnë në ligën e 3-të Perendim.

Sekretari bëri me dije se nuk kishte asnjë informacion për atë pikë dhe për shkak të mungesës së justifikuar të Valdetit, fjalën e mori:

Abdulla Sejdini- Ai njofton se ka qenë në dijeni dhe shkurtimisht do të shpjegojë. Ai theksoi se ishte e nevojshme që çdo klub futbollit të paguante një tarifë regjistrimi për garën në fillim. Në Kërçovë kishte tre klube futbollit dhe shuma ishte 75.000 denarë. Bëhej fjalë për ligën e tretë dhe ai nuk e dinte nëse ishte bërë në kohë apo ishte vonë.

Kryetari i këshillit vendosi për miratim Propozim Vendim për pagesën e kotizimit të klubeve futbollistike për sezonin 2023/2024 nga Komuna e Kërçovës të cilët garojnë në ligën e 3-të Perendim dhe e njeita u miratua me 21 vota PËR. KUNDËR (asnjë) PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit dha një pushim prej 10 minutash.

Pas pushimit kaloi në:

3. PIKA E TRETË: Raport për punën financiare për kuartalin e dytë, nga 01.01.2023 deri 30.06.2023 të NP”Komunalec” Kërçovë.

Përfaqshuesi nga „Komunalec,, - e ka shpjeguar raportin në mënyrë të detajuar dhe ka informuar se në atë periudhë kohore kanë realizuar fitim prej 2 milionë e 800 mijë denarë.

Agim Sadiku - Ai informoi se e ka shqyrtuar Raportin dhe se nuk ka dallim nga ai i 30.03.2023 dhe ka pyetur nëse ka qenë për tre, dy apo një periudhë apo për dy tremujorë. Raporti duhet të kishte bërë një krahasim dhe ndryshim midis dy tremujorëve. Ai theksoi se nuk e ka të qartë në lidhje me shpenzimet.

Përfaqsesi nga „Komunalec,, - bën me dije se rezultatet janë shënuar qartë. Raporti është përgatitur në bazë të udhëzimeve të revizioneve dhe ka qenë kumulativ nga 30.06.2023.

Agim Sadiku –Informoi se pikë ka qenë për kuartalin e dytë, dhe për të nuk ka pasur evidencë në shifra.

Përfaqsesi nga „Komunalec,, - ka theksuar se raporti është bërë në bazë të udhëzimeve të inspeksionit shtetëror.

Agim Sadiku- Informon se raporti është dashur të jetë për 3 dhe jo 6 muaj. Ai theksoi se duhet të përmirësohet në mënyrë që të gjithë ta kuptojnë. Njëra duhet të jetë deri më 30 mars dhe tjetra nga 1 prilli 2023 dhe më pas të jetë kumulative.

Përfaqsesi nga „Komunalec,, - bën me dije se nëse e kërkojnë, tash e tutje do të përgatitet kështu dhe se deri më tani nuk kanë pasur asnjë koment për këtë nga inspektimet.

Agim Sadiku- Bëri me dije se është raport për tremujorin e dytë, siç kanë pasur për tremujorin e parë. Pastaj mund të përgatitet në mënyrë kumulative, gjithashtu nuk ka pasur raport për të hyrat dhe shpenzimet dhe përqindjen e realizimit. Pyeti për shpenzimet në zërat 47 dhe 449 për avokatët dhe shpenzimet tjera, 600.000 denarë për çfarë sendesh dhe lëndësh u janë dhënë avokatëve.

Përfaqsesi nga „Komunalec,, - bën me dije se ato janë mjete për shërbime juridike dhe se Sektori juridik kishte evidencë për klientët dhe borxhet e tyre dhe përmbarimin e borxheve në „Komunalec,,.

Agim Sadiku- Informon se borxhet nuk janë ulur. Ai ka treguar se kanë pasur informacione se “Komunalec” është bllokuar për një shumë të caktuar. Ka pyetur se çfarë shume dhe nëse janë zhbllokuar, si është bërë kjo. Ai pyeti se nëse të punësuarit do të marrin pagë apo jo? Është e nevojshme që të respektohet ligji dhe komuna si themeluese është përgjegjëse për këtë.

Përfaqsesi nga „Komunalec,, - Informon se është këtu në lidhje me raportin dhe jo për të dhëna të përgjithshme që nuk ishin në kompetencë të tij. Ai informon se deri më tani janë paguar pagat dhe kontributet e punëtorëve.

Agim Sadiku - Ai ka theksuar se si përfaqësues është dashur të japë shpjegim edhe për këtë.

Përfaqsesi nga „Komunalec,, - Informon se deri më 30.06.2023 nuk ka pasur ndonjë bllokim të "Komunalec"

Agim Sadiku- Informon se si themelues duhet ta dinë gjendjen e ndërmarrjes. Ka pasur reagim nga qytetarët se në çdo dy muaj kanë marrë u ka shkuar pagesë për përmbaruesin.

Abdulla Sejdini - Ai ka pyetur se çfarë po ndodh me „Komunalecin,, sepse gjithmonë është thënë se është në fitim, ndërsa tani është bllokuar nga borxhi ndaj Studençicës. Ai pyeti se pse nuk është respektuar Marrëveshja e lidhur në vitin 2014.

Përfaqsesi nga „Komunalec,, - Informon se ndërmarrja është në vështirësi pas tremujorit të dytë, dhe deri atëherë gjithçka ka qenë ashtu siç thuhet në raport. Borxhi ishte i para vitit 2013. Një pjesë është paguar dhe është zvogëluar. Ai theksoi se si themelues mund të kishin marrë masa dhe të kërkonin likuidimin e borxhit deri në vitin 2013.

Abdulla Sejdini - Ai ka treguar se janë në kërkim të likuidimit kur ka pasur marrëveshje me „Komunalecin,, dhe marrëveshje shtesë deri në fund të vitit 2023. për vazhdimin e borxhin për pagesë.

Përfaqsesi nga „Komunalec,, - Informon se me rritjen e çmimit të ujit është rritur edhe borxh për pagesë.

Abdulla Sejdini – Pyet se pse nuk u zbatua Marrëveshja e vitit 2014, dhe tani ka pasur rritje të borxhit. Theksoi se çmimi i ujit, mbeturinave etj është rritur dy herë dhe pyeti nëse ishte një përgatitje për një rritje të re të çmimit të ujit dhe shërbimeve komunale. Ai bën të ditur se numri i anëtarëve të Bordit Drejtues është 7, ndërsa sipas Statutit ka qenë 5 dhe është e nevojshme ndryshimi i Statutit. Ai pyeti se sa është borxhi ndaj “Studençicës”.

Përfaqsesi nga „Komunalec,, -bën me dije se borxhi deri më 30.06.2023 ishte 17 milionë.

Abdulla Sejдини – Ai bën me dije se ata ishin kampionë të borxhit dhe se janë përpara Plasnicës dhe Drugovës.

Laze Jakimoski - Ai pyeti se nëse përfaqsesi nga „Komunalec,, i cili edhe është udhëheqës i sektorit të financave nuk e di, atëhere kush duhet ta dijë dhe është dashur të informohen se ndërmarrja është e bllokuar. Ai ka kërkuar që të marrin masa. Nëse janë bllokuar pas datës 30.06.2023, bllokohet brenda kornizës dhe do të ketë interes për të. Ai pyeti se pse janë bërë shpenzimet shtesë. Është bërë marrëveshje me një person juridik për mbajtjen e një makinerie balimi prej njëmijë e pesëqind euro dhe një aneks prej 65 mijë zvogëlimi dhe janë planifikuar 3 lokacione të tjera.

Përfaqsesi nga „Komunalec,, -Ai theksoi se vetë këshilltari e ka konfirmuar se deri më 30.06.2023 ndërmarrja nuk ishte e bllokuar. Ai kërkoi që të thirret një seancë dhe të flasin udhëheqësit për këtë. Ai është kompetent për punë financiare, jo për furnizime publike. Deri më 30.06.2023 gjithçka u tha siç duhet.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Raport për punën financiare për kuartalin e dytë, nga 01.01.2023 deri 30.06.2023 të NP”Komunalec” Kërçovë dhe u miratua me 11 vota PËR. 7 vota KUNDËR. 2 vota PËRMBAJTUR. Mihajlo Daniloski nuk ka votuar, sepse është i punësuar në ndërmarrjen.

4. PIKA E KATËRT: Propozim Vendim për miratimin e raportit për vlersimin e demit te fatkeqësive të ndryshme – Zjarr nr. 06- 464/2 më datë 28.02.2023

Igor Pejосki- Informon se pika 4, 5 dhe 6 dhe 7 janë për vlerësimin e dëmeve nga zjarri, e para dhe e treta për kasolle, koliba, e dyta për pemëtore dhe e katërta për një shtëpi. Ai theksoi se janë punuar kolektivisht dhe janë dërguar në Qeveri ndërsa prej andej kanë kërkuar që të veçohen dhe të shkojnë në këshill që të mund të paguhen.

Kryetari i këshillit e Propozim Vendim për miratimin e raportit për vlersimin e demit te fatkeqësive të ndryshme – Zjarr nr. 06- 464/2 më datë 28.02.202 dhe u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

5. PIKA E PESTË: Propozim Vendim për miratimin e raportit për vlersimin e demit te fatkeqësive të ndryshme – Zjarr nr. 06- 465/2 më datë 28.02.2023.

Kryetari i këshillit vuri për miratim Propozim Vendim për miratimin e raportit për vlersimin e demit te fatkeqësive të ndryshme – Zjarr nr. 06- 465/2 më datë 28.02.2023 dhe u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

6. PIKA E GJASHTË: Propozim Vendim për miratimin e raportit për vlersimin e demit te fatkeqësive të ndryshme – Zjarr nr. 06- 466/2 më datë 28.02.2023

Kryetari i këshillit e vuri për miratim Propozim Vendim për miratimin e raportit për vlersimin e demit te fatkeqësive të ndryshme – Zjarr nr. 06- 466/2 më datë 28.02.2023 dhe u miratua me 21 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

7. PIKA E SHTATË: Propozim Vendim për miratimin e raportit për vlersimin e demit te fatkeqësive të ndryshme – Zjarr nr. 06- 467/2 më datë 28.02.2023

Kryetari i këshillit vuri për miratim Propozim Vendim për miratimin e raportit për vlersimin e demit te fatkeqësive të ndryshme – Zjarr nr. 06- 467/2 më datë 28.02.2023 dhe u miratua me 21 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kalohet në:

8. PIKA E TETË: Miratimi i Programit Vjetor për punë të shkollave të Mesme në teritorin e Komunës së Kërçovës: SHMK “Drita” Kërçovë, SHMK “Mirko Mileski” Kërçovë.

Drejtori i SHMK „Drita,, - Informon se shkolla ka 537 nxënës në 38 paralele, 80 profesorë dhe 20 staf profesional. Ai theksoi se objekti i shkollës së mesme është në renovim dhe tani mësimi mbahet në Universitetin e Tetovës dhe në Internat. Ishte planifikuar edhe rinovimi i sallës sportive për të cilën kishte një projekt.

Abdulla Sejdini – Dha një korigjim pasi që në program është shkruar 542 nxënës, kurse drejtori ka thënë 537.

Drejtori i SHMK „Drita,,- bën të ditur se është bërë një gabim teknik dhe se numri ka qenë 537.

Abdulla Sejdini - Ai ka kërkuar sqarim më të detajuar për rikonstrukcionin e objektit, i cili ka filluar në qershor, dhe afati ka qenë deri më 1 dhjetor 2023, dhe a do të përfundojë deri atëherë sipas dinamikës së punëve.

Drejtori i SHMK „Drita,,- bën të ditur se deri atëherë është vështirë të përfundojnë punët, kontrata me fakultetin ka qenë deri më 1 shkurt me mundësi vazhdimi.

Abdulla Sejdini - Ai e falënderoi për sinqeritetin dhe pyeti se si po shkon mësimi në Universitetin e Tetovës dhe orët e sportit.

Drejtori i SHMK „Drita,,- bën të ditur se janë bashkuar 2 ose 3 paralele, pasi numri i tyre është 10-15 nxënës në një paralele dhe mësimi ka vazhduar normalisht. Për sa i përket sportit janë në negociata me kazermën, e cila ka një sallë sportive, ose mësimi do të zhvillohet në sallën e sportit në Ivanidol, ku nxënësit do të transportohen atje një ose dy herë në javë. Ai ka theksuar se është dashur të rregullohet deri në fund të shtatorit, në mënyrë që të fillojë zbatimi nga tetori.

Valbona Adili Emini pyeti nëse me rinovimin e shkollës do të rinovohet edhe çatia dhe do të vendosen panele diellore.

Drejtori i SHMK „Drita,,- bën me dije se nëse vendosen panele, një pjesë të energjisë elektrike do ta paguajë kompania e zgjedhur nga komuna. Çfarëdo marrëveshjeje që të lidhë komuna ashtu do të jetë, komuna është themeluese.

Laze Jakimoski - Ai e komentoi programin dhe pyeti se në cilën gjuhë është lëshuar te këshilltarët, sepse kishte shumë kllapa, presje etj. dhe ajo ishte e pakuptueshme.

Drejtori i SHMK „Drita,,- Ai theksoi se kjo është ndoshta për shkak të fondit, apo një gabim teknik dhe do të mundohen ta korrigjojnë.

Valentina Lazarevska- Informon se duhet t'i kushtohet vëmendje përmbajtjes dhe jo vetëm formës së programit. Nuk kishte kalendar të aktiviteteve për këtë vit.

Drejtori i SHMK „Drita,,- Ai ka treguar se do të kenë kujdes.

Kryetari i këshillit e vuri për miratim Miratimi i Programit Vjetor për punë të shkollave të Mesme në teritorin e Komunës së Kërçovës: SHMK “Drita” Kërçovë, SHMK “Mirko Mileski” Kërçovë dhe u miratua me 21 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Drejtori i SHMK, Mirko Mileski- Informon se programi është miratuar nga Bordi i shkollës dhe u është dorëzuar këshilltarëve në formë elektronike. Numri i studentëve në vitin e parë ndryshon, pasi studentët janë ende duke u regjistruar. Theksoi se janë 55 paralele, 14 prej të cilave janë turke. Mësimi zhvillohej në pesë profesione dhe për momentin kishte 831 nxënës. Mësimi po zhvillohet në tre objekte, për shkak të rinovimit të gjimnazit, përkatësisht në Fakultetin Juridik, Konviktin, kurse në objektin e Shkollës së Mesme paralelet e turqishtes zhvillonin mësimin. Ata kishin marrëveshje me Fakultetin Juridik deri më 1 shkurt 2024. Bëhet me dije se objekti i shkollës - Shkolla e mesme është ndërtuar në vitin 1952.

Valbona Adili Emini - Ajo pyeti se ku dhe si janë shpërndarë shërbimet pedagogjike dhe psikologjike, pasi nuk kishte disiplinë mes nxënësve në internat.

Drejtori i SHMK, Mirko Mileski - informon se atje ka pasur numrin më të madh të studentëve. Në sektorin pedagogjik-psikologjik ishin 4-5 persona dhe bënë rotacion çdo 2 javë në të gjitha ndërtesat.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Miratimi i Programit Vjetor për punë të shkollave të Mesme në teritorin e Komunës së Kërçovës: SHMK “Mirko Mileski” Kërçovë dhe u miratua me 21 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit dha një pushim prej 5 minutash.

Pas pushimit seanca vazhdoi.

9. PIKA E NËNTË: Miratimi i programeve vjetore për punën e shkollave fillore në territorin e komunës së Kërçovës: SHF “Sande Shterjoski” Kërçovë, SHF “Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë, SHF “Hristo Uzunov” Dërgovë, SHF “Rexh Rushit Zajazi” Zajaz, SHF “Milto Gurra” Strellcë, SHF “Naim Frashëri” Jagoll Dolencë, SHF “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Sërbicë, SHF “Faik Konica” Greshnicë.

Kryetari i këshillit informoi se për arsye shëndetësore në seancë nuk ka mundur të marrë pjesë drejtori i SHF “Sande Shterjoski” Kërçovë, dhe për sot autorizimin ka pedagogu.

Abdulla Sejdini - Informon se sipas Ligjit për Arsimin drejtori mund të zëvendësohet vetëm nga zëvendësdrejtori dhe kjo vlen për 5 vjet dhe sugjeroi që pedagogu të mos e shpjegojë programin, por zëvendësdrejtori apo drejtori.

Propozimin e këshilltarit Abdulla që Pedagogu të mos e sqarojë Programin, kryetari i këshillit e vendosi për miratim dhe është miratuar me: 11 vota PËR. 7 vota KUNDËR. 3 vota PËRMBAJTUR.

Valentina Lazarevska është e liruar nga votimi, sepse është e punësuar në këtë shkollë.

Abdulla Sejdini - Sygjeroi që të vijë drejtori apo zëvendësdrejtori dhe ta shpjegojnë programin.

Drejtori i SHF, Kuzman Josifoski Pitu- informoi se është zgjedhur UD Drejtoreshë nga data 18.08.2023, ndërsa programi është hartuar nga drejtori i mëparshëm dhe është dashur të dorëzohet deri më 14.08.2023. Theksoi se për programin nuk mund të thotë asgjë, sepse nuk e ka përgatitur vetë.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Programin vjetor të punës së SHF "Kuzman Josifoski-Pitu" Kërçovë dhe u miratua me 20 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Drejtori i SHF "Hristo Uzunov" Drugovë - informon se Programi është përgatitur dhe dorëzuar në Komunë me kohë. Theksoi se ka 2 shkolla rajonale në f.Sërbjan dhe f.Brzhdan. Dhe ajo qendërore në Drugovë. Informon se është rinovuar shkolla në f.Sërbjan, por edhe pse kërkoi ndihmë nga komuna dhe "Komunalec", atë nuk e mori. Ndihmë ka marrë nga Oslomej.

Anto Trajanoski - Ai pyeti se sa nxënës janë të regjistruar në klasën e parë dhe si sigurohet transporti i nxënësve në fshat. Cer.

Drejtori i SHF "Hristo Uzunov" në Drugovë - informon se në klasën e parë janë të regjistruar 8 nxënës, 7 në Drugovë dhe 1 në Sërbjan, nëpër Drugovë lëviz një furgon i vjetër, ndërsa në f.Cer ka shkuar një veturë komunale për një fëmijë.

Anto Trajanoski - Ai pyeti se sa mësimdhënës ka për 1 nxënës në Sërbjan.

Drejtori i SHF "Hristo Uzunov" Drugovë - Informon se në Sërbjan ka 12 nxënës dhe 1 arsimtare të cilët sipas ligjit janë ndarë në dy paralele.

Mihajlo Antoski - Ai pyeti nëse ka rizonim gjatë regjistrimit të nxënësëve.

Drejtori i SHF "Hristo Uzunov" Drugovë - informon se ka rizonim të nxënësve, por ligji parashikonte se prindërit mund të zgjedhin se ku do të mësojë fëmija.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Programin Vjetor të Punës së SHF "Hristo Uzunov" Drugovë dhe u miratua me 21 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Drejtori i SHF " Rexhë Rushit Zajazi ", Zajas - njofton se Programi është dorëzuar me kohë dhe është duke u zbatuar.

Abdulla Sejдини – Ai pyeti se në çfarë gjendje është salla e sportit dhe ku mbahet edukata fizike.

Drejtori i SHF " Rexhë Rushit Zajazi ", Zajas - njofton se nuk është funksionale dhe nuk punon, nuk ka pasur dokumente për të, drejtori i mëparshëm e ka njoftuar se kanë

qenë në komunë ndërsa në shkollë nuk ka dokumente për të. Ai theksoi se nuk mund të shkojnë atje pa dokumente.

Kryetari i këshillit bëri të ditur se salla është ndërtuar nga Agjencia për Rini dhe Sport, nuk ka pasur leje teknike dhe nuk e kanë ditur nëse komuna ka dokumente për të.

Abdulla Sejdini- Sygjeri të kërkon pranim teknik për të dhe ta përdorni.

Agim Sadiku - Kërkoj Raport nga autoritetet e NJVL Kërçovë për sallën e sportit deri në këshill për atë se si është bërë, pse nuk përdoret, ku ka filluar procesi dhe deri ku ka arritur. Ai pyeti se si është situata me regjistrimin e nxënësve.

Drejtori i SHF " Rexhë Rushit Zajazi ", Zajas – bën me dije se në klasën e parë kanë qenë 32 nxënës, ose 4 më shumë se vitin e kaluar.

Valentina Lazarevska – Ajo pyeti se sa është numri i përgjithshëm i nxënësve.

Drejtori i SHF " Rexhë Rushit Zajazi ", Zajas –Informon se ishin 292 nxënës.

Ramazan Zulbeari - Pyeti se kur ka qenë hera e fundit që drejtori e ka vizituar dhe a ka kushte pune në Rexhë Rushit Zajazi -Çelikaj.

Drejtori i SHF " Rexhë Rushit Zajazi ", Zajas – njofton se ka qenë të enjten, shkolla i ka plotësuar kushtet, vetëm se nuk ka pasur kushte për sport.

Ramazan Zulberi – Ai bën të ditur se ka pasur një reagim nga prindërit. Sanitaret ishin sjellë, por ende nuk ishin vendosur. Ai theksoi se saniteria në Xhuma ishte bërë shumë mirë. Sygjeri që të shkohet në Çelikaj dhe të shikohet situata atje, kishte lagështi dhe nuk kishte derë në WC-në.

Drejtori i SHF " Rexhë Rushit Zajazi ", Zajas - njofton se në Xhuma është realizuar nga prindërit, ndërsa do të rregullohet edhe në Çelikaj, do të vendosen objektet sanitare të dhuruara.

Kryetari i këshillite vendosi për miratim Programin Vjetor të Punës së SHF "Rexhë Rushit Zajazi" dhe u miratua me 21 vota PËR, KUNDËR (asnjë).PËRMBAJTUR (asnjë).

Drejtori i SHF,, Milto Gura,, Strelcë-Informon se Programi është miratuar nga Bordi i Shkollës dhe nga 14 gushti është duke u zbatuar.

Abdulla Sejdini – Informon se në Program kategorikisht thuhej se hapësira në f. Cërvevcë nuk i plotëson kushtet për një ndërrim dhe mësimi është zhvilluar në dy ndërrime. Ai pyeti se cilat ishin ato kushte që nuk plotësoheshin.

Drejtori i SHF,, Milto Gura,, Strelcë - bën të ditur se në program nuk ka pasur një gjë të tillë dhe që nga 1 shtatori i vitit të kaluar mësimi zhvillohet në një turn.

Abdulla Sejdini- Informon se tashmë për të dytin vit Programi është bërë “copy-paste”. Ai theksoi se ata e kishin programin final, që duhej korrigjuar dhe nuk duhej toleruar. Ai kërkoi që Programi të tërhiqet nga rendi i ditës.

Kryetari i këshillit - njofton se pajtohet me Abdullaun, këto ishin programet përfundimtare. Ishte e nevojshme të korrigjohej, si themelues duhet ta kishin kontrolluar, jo toleruar.

Agim Sadiku - Informon se pajtohet me Abdullaun dhe të gjithë drejtorët është dashur të përpiqen të përgatisin programe më efikase. Ai kërkoi që të tërhiqen ose miratohen të gjitha programet e shkollave në mënyrë që të jenë të njëjta për të gjithë dhe të mos hyjnë në detaje dhe që drejtorët e shkollave të kenë kujdes se çfarë u dorëzojnë për miratim.

Abdulla Sejdini - Informon se këtu e ka fjalën për SHF „Milto Gura,, por nëse ka pasur shkolla të tjera të tilla do të flasë edhe për to. Ai ka theksuar se shërbimet profesionale është dashur të kenë kujdes se çfarë kanë shkruar, sepse ka pasur mësimdhënës që nuk janë të punësuar në shkolla të caktuara dhe ende figurojnë. Ai kërkoi që të mos bëhen gabime të tilla në të ardhmen.

Drejtori i SHF „Milto Gurra,,Strelcë - bën të ditur se ka qenë gabim teknik dhe se versionin përfundimtar do ta dërgojë pas seancës. Ai theksoi se mund të jetë gabim i tij që është dërguar kështu dhe pyeti nëse mund të miratohet.

Abdulla Sejdini- Informon se qëndron në atë të tërheqjes së Programit.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim propozimin e Abdullaut, Programi të tërhiqet nga rendi i ditës dhe propozimi u miratua me 13 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 7 vota PËRMBAJTUR.

Drejtori i SHF, Naim Frasheri, Jagoll Dolenc- bën me dije se programi është realizuar në kohë.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Programin e SHF, Naim Frasheri, Jagoll Dolenc dhe u miratua me 21 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Drejtori i SHF "Gjergj Kastrioti" - Sërbicë - njofton se mësimi zhvillohet në Novosellë dhe Sërbicë me 83 nxënës në një turn.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Programin e SHF "Gjergj Kastrioti" - Sërbicë dhe u miratua me 21 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Drejtori i SHF „Faik Konica,, Greshnicë- Shpjegoi programin.

Valbona Adili Emini- Informon se mësuesit e asaj shkolle kanë kopjuar materiale për vetë nxënësit dhe nuk bëhej fjalë për Teste, por për Projekte.

Drejtori i SHF „Faik Konica,, Greshnicë - bën me dije se në shkollë egziston një fotokopjues dhe është furnizuar me letër, që të kopjohet për nevojat e shkollës. Ajo pyeti nëse ka persona të tillë që të merren masa.

Kryetari i këshillit - informon se aty ka pasur një fotokopjues dhe janë bërë shërbime, e nëse njëri nga mësuesit nuk ka mundur të presë në radhë dhe ka ardhur në qytet për të kopjuar, kjo ishte çështje tjetër.

Kryetari i këshillit e vuri për miratim programin e SHF „Faik Konica,, Greshnicë dhe u miratua me 21 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Zëvendësdrejtori i SHF “Sande Shterjoski” - Informon se Programi ishte nga drejtori i mëparshëm. Ai theksoi se shkolla në “Agrokop” u mbyll, dhe 6 paralele u transportuan në shkollën e re. Shkolla punoi me dy turne për një muaj.

Abdulla Sejdini – Ai bën me dije se programi i tyre ka 5 vite që është “copy-paste” dhe në të ka vite që nuk ndryshojnë edhe datat. Programi listonte mësues që nuk punonin atje. Ai kërkoi që Programi të tërhiqet dhe të korrigojohet.

Kryetari i këshillit e vuri për miratim propozimin e Abdullait, Programi të tërhiqet nga rendi i ditës dhe propozimi u miratua me 20 vota PËR. 1 votë KUNDËR. 1 votë PËRMBAJTUR.

10. PIKA E DHJETË: Propozim Vendimi për Rikonstuimin e shkollës së parë në gjuhën maqedone në teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në fshatin Podvis.

Sekretarja- Informon se nga drejtoria për mbrojtjen e monumenteve ka pasur kërkesë për mbrojtjen e shkollës. Fillimisht duhej rregulluar rruga e hyrjes që nuk ishte e mirë dhe më pas të bëhej një Projekt.

Laze Jaqimoski - Ai informon se për këtë ka votuar edhe përbërja e mëparshme e këshillit. Është kërkuar disa herë rregullimi i rrugës. Ai pyeti nëse sillet sot Vendim, a do të merret dicka me të vërtetë . Ai theksoi se tani më datë 23-24 shtator ishte ditë jubilarë dhe nuk mund të shkonin atje.

Sekretarja - Informon se nuk është në dijeni se është marrë një vendim i tillë, e as në administratë nuk ka pasur një vendim të tillë, ndoshta ka qenë një konkluzion. Ajo theksoi se është e nevojshme të ndërtohet rruga dhe shkollë. Shteti kishte siguruar një pjesë të fondeve. Mjafton të përgatitej një Elaborat, pastaj një Projekt e kështu me radhë.

Kryetari i këshillit e vendosi Propozim Vendimi për Rikonstuimin e shkollës së parë në gjuhën maqedone në teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në fshatin Podvis dhe u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR(asnjë).

11. PIKA E NJËMBËDHJETË: Miratimi i planit vjetor për punësim për vitin 2024 dhe Balancier për Universitetin e punës „Krste Misirkov,, Kërçovë.

Drejtori i Universitetit të Punës, Kërste Misirkov, shpjegoi planin vjetor dhe informoi se për këtë vit është planifikuar punësimi në tre vende pune.

Kryetari i këshillit vendosi për miratim Miratimi i planit vjetor për punësim për vitin 2024 dhe Balancier për Universitetin e punës „Krste Misirkov,, Kërçovë dhe u miratua me 17 vota PËR. KUNDËR (asnjë).PËRMBAJTUR (asnjë).

12. PIKA E DËMBËNDËMBËTË: Vendim për ndryshimin e Rregullores për llogaritjen e pagave të nëpunësve publikë në Komunën e Kërçovës.

Kryetari i Këshillit - Informon se Sekretari i ka shpjeguar tre pikat e mëposhtme në fillim të seancës kur janë propozuar.

Kryetari i këshillit vendosi për miratim Vendim për ndryshimin e Rregullores për llogaritjen e pagave të nëpunësve publikë në Komunën e Kërçovës dhe u miratua me 15 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 1 votë PËRMBAJTUR.

13. PIKA E TREMBËDHJETË: Vendim për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e vlerës së pikës për pagat e zyrtarëve administrativë për vitin 2023.

Kryetari i këshillit vuri për miratim Vendim për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e vlerës së pikës për pagat e zyrtarëve administrativë për vitin 2023 dhe u miratua me 16 vota për. 1 votë KUNDËR 1 votë PËRMBAJTUR.

14. PIKA E KATËMBËRMBËDHJETË: Vendim për ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e pagave, shtesave dhe kompensimeve të pagave të punëtorëve të NJTKZ Kërçovë të cilët kanë statusin e zyrtarëve të autorizuar në fushën e sigurisë.

Kryetari i këshillit vendosi për miratim Vendim për ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e pagave, shtesave dhe kompensimeve të pagave të punëtorëve të NJTKZ Kërçovë të cilët kanë statusin e zyrtarëve të autorizuar në fushën e sigurisë dhe u miratua me 16 vota PËR. 2 vota KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

15. PIKA E PESËMBËDHJETË: Të ndryshme

Laze Jakimoski - Ai informoi se në aplikacionin për nxënës dhe studentë disa nga përgjigjet janë vetëm në gjuhën shqipe dhe jo në gjuhën maqedonase, ka theksuar se mund të ketë qenë gabim teknik dhe ka kërkuar që të korrigohet.

Është dorëzuar kërkesë nga Shoqata e Invalidëve të Luftës dhe Veteranëve „Vllazëria,, - e lexoi këshilltari Laze Jakimoski. Në të kërkohet që anëtarët e shoqatës: punësim në ndërmarrjet publike, përjashtim nga taksat, tarifat komunale, blerjen e drunjve për zjarrit me këste dhe kërkesa të tjera. Ai bën me dije se të njëjtën kërkesë Shoqata e ka parashtruar në të gjitha komunat.

Valentina Lazarevska - Ajo pyeti se deri ku është ndërtimi i sallës së sportit në SHF „Kuzman Josifoski-Pitu,, sepse raporti ishte gati.

Sekretari- Informon se salla është përfshirë në projektin e ri urbanistik. Por ndërkohë deri sa të zgjidhet kjo, mjetet që ishin paraparë për të u transferuan në një komunë tjetër.

Vikor Aleksoski - Informoi se nga SHF "Vladimir Polezhinoski" nuk është zgjidhur kërkesa në lidhje me gypat, dhe pyeti se deri ku është rindërtimi i rrugës për në fshat. Koziçino.

Sekretarja – bën me dije se është diskutuar në lidhje me gypat me “Komunalecin”, ndërsa në lidhje me atë se deri në çfarë mase është rikonstruksioni i rrugës nuk ka informacion.

Meqenëse askush tjetër nuk e morri fjalën, dhe kështu u shterë rendi i ditës për këtë seancë, Kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës e mbylli seancën e Këshillit në ora 12:10 minuta.

Procesverbalist

-Lençe Srbinoska

-Elisaveta Mileska

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Kryetar

Skender Xhabiri d.v.

